# DËSHMI ARKIVI

**A-477501**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tahiraj kritikon deklaratën për Specialen dhe kërkon shpjegime nga LDK-ja për Besian Mustafën |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/tahiraj-kritikon-deklaraten-per-specialen-dhe-kerkon-shpjegime-nga-ldk-ja-per-besian-mustafen/1031664/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 19:28:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 19:24:28 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f49276bd3bd10c8aac5744d2c662e174de932236446d1b2ef2f3ba9b21129fc1` |
| TEKSTI | `233032865c6f184599dba6949262d1f55ebbc0d3fef7cbe727ada8ab8413c7d3` |
| PAMJA | `30813c1c1969fe6d1101859e17e76bcfd8ec7932e023ab8457ac9467c9b664f9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5823a71f6a9e0416d4986b597cc36f045e9731ad81fe7f3b5c2345b3a856c6e6` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5823a71f6a9e0416d4986b597cc36f045e9731ad81fe7f3b5c2345b3a856c6e6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Tahiraj kritikon deklaratën për Specialen dhe kërkon shpjegime nga LDK-ja për Besian Mustafën



Kuvendi i Kosovës miratoi në seancën e parë plenare një deklaratë lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Speciale në Hagë ndaj katër ish-drejtuesve të UÇK-së.

Përmes këtij dokumenti, deputetët e cilësuan të papranueshëm përfundimin se mes katër të akuzuarve ka ekzistuar një qëllim i përbashkët kriminal.

Veprimtari Saim Tahiraj e konsideroi paradoks faktin që Kuvendi, i cili votoi për krijimin e Gjykatës Speciale, tashmë po kundërshton një vendim të saj. Në një deklaratë për "Bota sot", ai ngriti shqetësime për respektimin e ndarjes së pushteteve dhe për mesazhin që ky qëndrim, sipas tij, i përcjell opinionit ndërkombëtar.

"Kuvendi i Kosovës miratoi sot një deklaratë kundër vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Speciale në Hagë, e cila dha dënime ndaj katër personave të akuzuar për krime lufte. Një veprim i tillë përbën një paradoks të jashtëzakonshëm.

I njëjti institucion që, së bashku me miqtë tanë ndërkombëtarë, votoi themelimin e kësaj gjykate, sot po del në kundërshtim me një vendim të saj. Këta miq na ndihmuan në çlirimin e vendit dhe në ndërtimin e shtetit tonë.



të fundit/

Tahiraj kritikon deklaratën për Specialen dhe kërkon…

A mund të ndryshohet ligji për Specialen dhe të falen të dënuarit?…

Roberto Carlos: 11 fëmijë, 7 gra, 3 Liga të Kampionëve dhe një…

Dita e 121 e protestës në Tiranë, qytetarët marshojnë drejt "Qyte…

Esposito shkruajnë historinë e Italisë, përsëritet një rekord…

Qendra "Gjenocidi në Kosovë – Plagë e hapur" mirëpret…

Haxhiu: Kuvendi duhej të shprehte qëndrimin për aktgjykimin e…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium



Ku mbetet morali njerëzor në këtë rast? Për moral politik duket se nuk mund të flasim, pasi ai është zhdukur prej kohësh.

Situata bëhet edhe më paradoksale kur ata që ndërmarrin një veprim të tillë përsërisin se pushtetet janë të ndara dhe se drejtësia nuk duhet të ndikohet nga askush.

Çfarë ndodhi sot në Kuvend dhe çfarë mesazhi iu dha botës? Si mundet një institucion politik të marrë qëndrim kundër një vendimi gjyqësor dhe njëkohësisht të pretendojë se e respekton ndarjen e pushteteve?

Deputetët e padinjitetshëm mund të thonë se kjo nuk përbën ndërhyrje në drejtësi, por qytetarët kanë të drejtë ta vlerësojnë vetë atë që ndodhi", u shpreh Tahiraj.

Ai kritikoi gjithashtu LDK-në për largimin e deputetit Besian Mustafa nga seanca dhe kërkoi të sqarohet se çfarë mesazhi përcolli ky veprim.

Sipas Tahirajt, përgjegjësia për krimet duhet të përcaktohet në mënyrë individuale, ndërsa lufta çlirimtare e Kosovës nuk duhet të mbrohet përmes ndërhyrjeve politike të Kuvendit, por nëpërmjet së vërtetës dhe drejtësisë.

"Deputetët e LDK-së duhet t'i përgjigjen edhe një pyetjeje tjetër: përse Besian Mustafa, djali i Xhemajl Mustafës, u largua nga mbledhja e Kuvendit? Çfarë mesazhi ishte ky dhe pse nuk qëndroi në sallë? Këto janë çështje që kërkojnë përgjigje.

Turpi ju mbuloftë! Me çfarë fytyre do t'u kërkoni nesër qytetarëve votën, kur me veprimet tuaja po e humbni atë sot?

Paradoksi më i madh qëndron në faktin se, ndërsa Gjykata Speciale po zhvillon proceset për të përcaktuar përgjegjësinë individuale për krimet e pretenduara gjatë luftës, përfaqësuesit e popullit po përpiqen ta mbrojnë politikisht një palë nga një vendim gjyqësor.

UÇK-ja dhe lufta çlirimtare e Kosovës nuk kanë nevojë për mbrojtje politike nga Kuvendi. Ato kërkojnë të vërtetën dhe drejtësinë.

Krimi ka emër dhe përgjegjësia duhet të jetë individuale, ndërsa lufta për çlirimin e Kosovës është një çështje krejt tjetër. Turp ju qoftë", përfundoi Tahiraj.

Shtuar më 28.09.2026 21:24

Tags: Kuvendi i Kosoves , ldk , Tmerr



Haxhiu: Tensionet politike më shtynë të prisja para thirrjes së seancës



A mund të ndryshohet ligji për Specialen dhe të falen të dënuarit? Përgjigjet ish…



Qendra "Gjenocidi në Kosovë – Plagë e hapur" mirëpret qëndrimin e…



Haxhiu: Kuvendi duhej të shprehte qëndrimin për aktgjykimin e padrejtë



BE shqyrton afate për anëtarësimin e katër vendeve, ndërsa Kosova,…



Mbetjet mortore të dy personave identifikohen, nuk i përkasin "Grupit të…



Fetoshi: Fjalimi i Vuçiqit në OKB synoi t'i bëjë presion Perëndimit



Remi rikthen thirrjen për një bashkëqeverisje mes VV-së dhe PDK-së




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.